

**Vendim nr. 4 datë 21.01.2025**

**(V- 4/25)**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Ilir Toska, Genti Ibrahimimi, Sandër Beci, Marjana Semini, Marsida Xhaferllari, anëtarë, me sekretare Belma Lleshi, në datën 21.01.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 10 (T) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që u përket:

**KËRKUES:** TOM DEDAJ

**SUBJEKTE TË INTERESUARA:**

**KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË**, përfaqësuar nga Danja Hobdari dhe Albion Salaj me autorizim.

**PROKURORIA E PËRGJITHSHME**, në mungesë.

**PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM DIBËR**, përfaqësuar nga drejtuesi Abaz Muça.

**OBJEKTI:** Shfuqizimi i vendimit nr. 50 (86-2024-1175), datë 19.06.2024 të Gjykatës Administrative të Apelit si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6, 8 dhe 11 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

**GJYKATA KUSHTETUESE,**

pasi dëgjoji relatoren e çështjes Marsida Xhaferllari, mori në shqyrtim prapësimet me shkrim të kërkuarit Tom Dedaj (*kërkuesi*), i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Këshillit të Lartë të Prokurorisë (*KLP*), që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër (*Prokuroria Dibër*) që ka kërkuar rrëzimin e padisë, konstatoi mungesën e prapësimeve me shkrim të subjektit tjetër të interesuar Prokurorisë së Përgjithshme, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

## V Ë R E N:

### I

#### Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi ka ushtruar detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër (*sot Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër*) nga data 01.12.2013 deri në datën 01.11.2016, kur është pezulluar me vendim të Prokurorit të Përgjithshëm, për shkak se ndaj tij kishte filluar një procedim penal. Pas deklarimit fajtor të kërkuarit me vendim gjyqësor të formës së prerë, KLP-ja, me vendimin nr. 22, datë 28.01.2019, ka vendosur shkarkimin e tij nga detyra e prokurorit. Kërkuesi ka vazhduar rrugën gjyqësore përmes ushtrimit të mjeteve të ankimit ndaj vendimit të shkarkimit.

2. Gjatë kohës së pezullimit drejtuesi i Prokurorisë Dibër ka nxjerrë urdhrin e datës 13.09.2017, në zbatim të të cilit kërkuari është paguar me pagën minimale sipas nenit 110 të ligjit nr. 96/2016, datë 06.10.2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 96/2016*). Në datën 30.11.2018 atij i është ndërprerë pagesa dhe, për këtë shkak, në datën 21.12.2021, ka ngritur padi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke kërkuar dhënien e pagës nga data 01.12.2018 e në vazhdim, si dhe përqindjen e interesit për vonesat në dhënien e pagës. Çështja është regjistruar me nr. 31138–07074–80–2021, datë 22.12.2021.

3. Në datën 23.12.2021, nëpërmjet shortit elektronik, çështja e kërkuarit i është caktuar për shqyrtim një gjyqtari, i cili ka filluar shqyrtimin gjyqësor, por nuk e ka përfunduar atë për shkak të emërimit në Gjykatën Administrative të Apelit. Në datën 13.05.2022 çështja i është nënshtruar sërish shortit elektronik dhe i është caktuar një gjyqtari tjetër, i cili, gjithashtu, ka filluar shqyrtimin gjyqësor, por është larguar nga detyra si pasojë e procesit të rivlerësimit kalimtar. Në datën 06.09.2023 çështja e kërkuarit i është nënshtruar për herë të tretë shortit elektronik dhe i është caktuar gjyqtarit të tretë, i cili, pasi ka kryer veprimet përgatitore në datën 12.09.2023, ka vendosur përsëritjen tërësore të hetimit gjyqësor dhe ka caktuar seancën përgatitore në datën 15.10.2024, duke urdhëruar njoftimin e palëve.

4. Gjatë kohës që çështja ishte në pritje për shqyrtim në seancën përgatitore nga gjyqtari i tretë, në datën 15.05.2024 kërkuesi ka paraqitur kërkesë në Gjykatën Administrative të Apelit për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm të gjykimit, bazuar në nenet 399/1 e vijues të Kodit të Procedurës Civile (KPC). Gjykata Administrative e Apelit, pasi ka marrë mendimin me shkrim nga gjyqtari relator i çështjes në gjykatën e shkallës së parë, me vendimin nr. 50 (86-2024-1175), datë 19.06.2024, ka vendosur rrëzimin e kërkesës, me arsyetimin se gjykata e shkallës së parë ka qenë në pamundësi objektive për të gjykuar çështjen brenda afatit ligjor për shkak të volumit të lartë të çështjeve.

5. Në datën 09.07.2024 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me ankim kushtetues individual, sipas objektit, i cili, pasi është plotësuar me dokumentet e kërkuara, referuar parashikimeve të nenit 27 të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 17.07.2024. Kolegji i Gjykatës në datën 01.10.2024, bazuar në nenin 21, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

6. Në datat 31.10.2024 dhe 17.11.2024 kërkuesi ka paraqitur dy kërkesa për përjashtimin e dy gjyqtarëve nga shqyrtimi i çështjes së tij, për të cilat Mbledhja e Gjyqtarëve, me vendimet përkatësisht të datave 05.11.2024 dhe 19.11.2024, ka vendosur rrëzimin e tyre, me arsyetimin se nuk plotësoheshin kushtet e përcaktuara në pikën 1 të nenit 36 të ligjit nr. 8577/2000.

## II

### Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

7. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se i është cenuar:

7.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektin e *së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm*, pasi çështja e tij ka mbi 2 vjet në pritje të gjykimit në shkallë të parë dhe ende nuk ka nisur shqyrtimi i saj, ndonëse sipas parashikimeve të KPC-së ajo duhej të ishte gjykuar brenda 1 viti.

7.2. *Parimi i mosdiskriminimit*, i garantuar nga neni 18 i Kushtetutës, pasi gjykatat në rastin e tij kanë shkelur Kushtetutën, kodet, ligjet dhe legjisllacionin evropian për të drejtat e njeriut, duke i shkaktuar pengesa për mosrealizimin e të drejtave që i takojnë. Sipas kërkuetit, sjellja diskriminuese ndaj tij mund të vijë si pasojë e përkatësisë fetare, politike e krahinore ose për shkak të detyrës që ai ka kryer, pasi kolegë të tij

për situata të njëjta janë dëmshpërblyer. Në ndryshim nga ata, të cilët janë paguar deri sa u kanë përfunduar çështjet, atij i është ndërprerë paga padrejtësisht prej 8 vjetësh.

8. **Subjekti i interesuar, KLP-ja**, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar se pretendimi për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në aspektin e gjykimit brenda afatit të arsyeshëm është i pabazuar, pasi gjykata ka qenë në pamundësi objektive për shqyrtimin e çështjes për shkak të ngarkesës dhe zëvendësimit të gjyqtarëve të mëparshëm si pasojë e efekteve të reformës në drejtësi. Seanca përgatitore e caktuar në datën 15.10.2024 është shtyrë për në datën 11.11.2024, pasi kërkuesi ndodhej jashtë vendit për arsye shëndetësore dhe gjykimi ishte duke vijuar normalisht në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

9. **Subjekti i interesuar, Prokuroria Dibër**, ka përcjellë prapësimet e dërguara më herët në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë lidhur me parashtrimet për themelin e çështjes, sipas të cilave ajo ka përmbushur detyrimet e rrjedhura nga neni 110 i ligjit nr. 96/2016, ndaj ka kërkuar rrëzimin e padisë së kërkuesit si të pabazuar në ligj.

10. **Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme**, nuk ka paraqitur prapësime me shkrim edhe pse është njoftuar rregullisht nga Gjykata.

### III

#### Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

##### A. Për legjitimitimin e kërkuesit

11. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

12. Gjykata vëren se kërkuesi në ankimin kushtetues individual ka kërkuar shfuqizimin e vendimit të gjykatës së apelit që ka rrëzuar kërkesën e tij për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm, përshpejtimin e gjykimit dhe dhënien e një dëmshpërblimi të drejtë. Ndërsa në parashtrimet e depozituara për seancën plenare, që mbajnë datat 14.10.2024 dhe 17.11.2024, ai ka kërkuar edhe shfuqizimin e pikës 2 të nenit 399/8 të KPC-së si antikushtetuese, e cila parashikon se “Vendimi i gjykatës është përfundimtar dhe i formës së prerë”, me argumentin

se i është cenuar e drejta e ankimit në Gjykatën e Lartë, argument i cili nuk është parashtruar në ankimin fillestar.

13. Gjykata vëren se kërkesa për shfuqizimin e normës ligjore përbën kërkim të veçantë, pasi shton njëkohësisht objektin dhe shkakun ligjor të ankimit. Në kushtet kur kërkesa është paraqitur pas kalimit të çështjes në seancë plenare, Gjykata, bazuar në nenet 1, pika 2 dhe 43/b, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000, të lexuar në kombinim me nenin 185, pika 1, të KPC-së, çmon se ajo nuk mund të merret në shqyrtim gjatë këtij gjykimi kushtetues, sepse duhet të respektojë kriteret e përgjithshme të formës dhe afateve dhe t'i nënshtrohet procedurës së shqyrtimit paraprak.

14. Në lidhje me kërkimet e tjera Gjykata vlerëson se kërkuesi, si bartës i të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara nga Kushtetuta, legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi është palë ndërgjyqëse në çështjen gjyqësore, për të cilën ka pretenduar se i është cenuar e drejta për gjykim brenda afatit të arsyeshëm.

15. Për sa i takon shterimit të mjeteve juridike efektive, Gjykata vëren se kërkuesi, bazuar në nenet 399/1 e vijues të KPC-së, i është drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit me kërkesë për konstatimin e shkeljes, kërkesë e cila është rrëzuar me vendimin nr. 50 (86-2024-1175), datë 19.06.2024. Për rrjedhojë, i vetmi mjet në dispozicion i kërkuetit për rivendosjen e së drejtës së cenuar është ankimi kushtetues individual.

16. Në lidhje me afatin e paraqitjes së ankimit kushtetues individual, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës në datën 09.07.2024, ndërsa vendimi gjyqësor që ka rrëzuar kërkesën për konstatimin e shkeljes mban datën 19.06.2024. Në këto rrethana, Gjykata vlerëson se kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, sepse jo vetëm që shkelja është vazhduese, por edhe ankimi kushtetues individual është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000.

17. Në drejtim të legjitimitetit *ratione materiae*, kërkuesi ka pretenduar se gjykatat administrative të shkallës së parë dhe apelit nuk i kanë garantuar të drejtën kushtetuese për gjykimin e çështjes së tij (që lidhet me ndërprerjen e padrejtë të pagës prej vitit 2018) brenda afatit të arsyeshëm dhe se ato kanë pasur sjellje diskriminuese, pasi kolegët e tij në të njëjtat situata e kanë përfituar pagesën deri në përfundim të proceseve gjyqësore. Lidhur me pretendimin për cenimin e parimit të mosdiskriminimit kërkuesi ka parashtruar vetëm argumentin hipotetik se shkakun mund të lidhet me përkatësinë fetare, krahinore ose detyrën e ushtruar, por pa dhënë ndonjë detaj për rrethanat faktike personale të tij dhe as për ato të sjelljes së gjykatave të zakonshme. Në këtë situatë, Gjykata çmon se ky pretendim i kërkuetit nuk

mund të merret në shqyrtim, sepse argumentet e paraqitura janë të pamjaftueshme nga pikëpamja kushtetuese.

18. Për sa i takon pretendimit për cenimin e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, Gjykata vëren se kjo e drejtë garantohet nga neni 42 i Kushtetutës, ndaj pretendimi bën pjesë në juridiksionin kushtetues dhe do të analizohet në themel.

### *B. Për themelin e pretendimeve*

#### *B.1. Për shqyrtimin e çështjes brenda një afati të arsyeshëm*

19. Kërkuesi ka pretenduar se i është cenuar e drejta për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, pasi çështja e tij është regjistruar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë në vitin 2021, megjithatë gjykimi është ende në fazën fillestare, pasi nuk ka nisur shqyrtimi gjyqësor.

20. Subjekti i interesuar, KLP-ja, ka prapësuar se gjykimi është duke vijuar normalisht në gjykatën e shkallës së parë, seanca përgatitore e datës 15.10.2024 është shtyrë me kërkesë të kërkuesit, pasi ai ndodhej jashtë vendit për arsye shëndetësore dhe seanca e radhës ishte caktuar për në datën 11.11.2024. Gjykata e shkallës së parë, sipas KLP-së, ka qenë në pamundësi objektive për përfundimin e çështjes për shkak të ngarkesës dhe zëvendësimit të gjyqtarëve si pasojë e reformës në drejtësi. Sipas KLP-së, nuk ekziston ndonjë arsye e veçantë për shqyrtimin me përparësi të çështjes së kërkuesit në raport me çështje të ngjashme ose të regjistruara më herët në atë gjykatë.

21. Ndërsa, subjekti tjetër i interesuar, Prokuroria Dibër, nuk ka prapësuar konkretisht për pretendimin, por ka parashtruar se lidhur me themelin e çështjes ajo ka zbatuar detyrimet ligjore për ndërprerjen e pagës së kërkuesit.

22. Neni 42 i Kushtetutës parashikon, ndër të tjera, se kushdo për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese dhe ligjore ka të drejtën e një gjykimi brenda një afati të arsyeshëm. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka vlerësuar se kohëzgjatja e gjykimit, normalisht, llogaritet nga momenti i fillimit të procesit gjyqësor deri në dhënien e vendimit dhe se në kohëzgjatjen e përgjithshme të gjykimit nuk përjashtohen vonesat e shkaktuara nga zbatimi i reformës në drejtësi, pasi barra e këtyre vonesave nuk duhet të zhvendoset te palët ndërgjyqëse (*shih vendimet nr. 57, datë 17.09.2024; nr. 2, datë 17.02.2022; nr. 33, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Në çështjen konkrete, Gjykata vëren se mosmarrëveshja që po gjykohet nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka në objektin e saj kundërshtimin e ndërprerjes së pagës së prokurorit për shkak të pezullimit nga detyra deri në shkarkimin e tij. Çështja është

regjistruar në gjykatën e shkallës së parë në datën 22.12.2021 dhe ndonëse kanë kaluar 3 vjet, ajo është ende në fazën fillestare të saj, atë të veprimeve përgatitore.

24. Duke iu referuar nenit 399/2, pika 1, shkronja “a”, të KPC-së, Gjykata vë në dukje se kohëzgjatja e gjykimit të çështjes së kërkuesit ka tejkaluar trefish afatin 1-vjeçar të përcaktuar nga ligji si i arsyeshëm për përfundimin e gjykimit administrativ në gjykatën e shkallës së parë. Në këto rrethana, për të vlerësuar nëse kërkuesit i është cenuar e drejta kushtetuese për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, Gjykata do të analizojë rrethanat e veçanta të çështjes konkrete dhe kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese që lidhen me: (i) sjelljen e kërkuesit; (ii) kompleksitetin e çështjes; (iii) sjelljen e autoriteteve; (iv) rëndësinë e asaj çfarë rrezikon kërkuesi (*shih vendimet nr. 46, datë 03.10.2023; nr. 6, datë 16.02.2023; nr. 13, datë 26.05.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Për sa i takon *sjelljes së kërkuesit*, merr rëndësi të analizohen rrethanat nëse ai ka vepruar në përputhje me të drejtat procedurale, duke shfaqur ose jo interes të vazhdueshëm për gjykimin e çështjes brenda një afati sa më të përshtatshëm për të dhe nëse është bërë shkak ose ka shkaktuar vonesa në këtë drejtim (*shih vendimet nr. 57, datë 17.09.2024; nr. 6, datë 16.02.2023; nr. 35, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Gjykata, bazuar në aktet e dosjes gjyqësore të kërkuesit, konstaton se ai ka shfaqur interes për ecurinë e shpejtë të gjykimit të çështjes, pasi i është drejtuar gjykatës së apelit me kërkesë për përshpejtimin e procedurave, e cila është rrëzuar dhe, në vijim, ka paraqitur ankim kushtetues individual. Në këto rrethana, nuk rezulton që kërkuesi të jetë bërë shkak për vonesën në gjykim, por ka vepruar në përputhje me të drejtat procedurale.

27. Në lidhje me *kompleksitetin e çështjes*, Gjykata vëren se çështja ka në objektin e saj kërkimin për pagën e prokurorit dhe interesat për vonesën, bazuar në ligjin nr. 96/2016, për shkak të së cilës, sipas ligjit procedural, ajo shqyrtohet me trup gjykues të përbërë nga gjyqtari i vetëm. Ndërsa palë të paditura në gjykim janë tre institucione shtetërore, KLP-ja, Prokuroria e Përgjithshme dhe Prokuroria Dibër. Duke iu referuar këtyre aspekteve, Gjykata vlerëson se çështja e kërkuesit nuk paraqitet komplekse, e tillë që të justifikojë kohëzgjatjen prej 3 vjetësh në gjykatën e shkallës së parë.

28. Për sa i përket *sjelljes së autoriteteve*, Gjykata vë në dukje se lloji i çështjes së kërkuesit, për nga objekti i saj, përfshihet në grupin e çështjeve prioritare për shqyrtim, me objekt zgjidhjen e mosmarrëveshjeve nga marrëdhënia e punës ose ato që rrjedhin nga shpërblimi i dëmit nga zgjidhja e marrëdhënies së punës (*shih shkronjën “gj” të pikës 3.1. të vendimit nr. 78, datë 30.05.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në gjykatën e apelit”, të ndryshuar [vendimi nr. 78/2019]*). Megjithatë, nuk rezulton që gjykimi të jetë zhvilluar me përparësi. Konkretisht, çështja e kërkuesit i është caktuar me



short me radhë tre gjyqtarëve të ndryshëm, konkretisht në datat 23.12.2021, 13.05.2022 dhe 06.09.2023, për shkak të largimit të dy gjyqtarëve të parë (gjyqtari i parë për shkak të ngritjes në detyrë, ndërsa gjyqtari i dytë për shkak të procesit të rivlerësimit kalimtar). Dy gjyqtarët e parë kanë kryer veprime gjyqësore, duke filluar shqyrtimin gjyqësor të çështjes përmes marrjes së provave dhe debatimit të tyre, por nuk kanë mundur ta përfundojnë gjykimin. Gjyqtari i fundit i caktuar me short në datën 06.09.2023, pas 6 ditëve, ka nxjerrë urdhrin sipas ligjit procedural për të përsëritur tërësisht hetimin gjyqësor. Megjithatë, gjyqtari e ka kthyer çështjen në fazën e veprimeve përgatitore, të cilën e ka caktuar pas 1 viti e 1 muaji, konkretisht në datën 15.10.2024, duke mos dhënë ndonjë arsye specifike në këtë drejtim, që do të thotë se nuk ka mbajtur në konsideratë as kohën e regjistrimit të çështjes, as natyrën prioritare të saj.

29. Ndërkohë, Gjykata Administrative e Apelit ka rrëzuar kërkesën për konstatimin e shkeljes dhe përshejtimin e procedurave, pa iu referuar rrethanave konkrete të rastit, por duke përdorur një arsyetim formal e standard. Sipas gjykatës së apelit, gjykata e shkallës së parë është në pamundësi objektive për të proceduar shpejt, për shkak të evadimit të çështjeve në kushtet e numrit të kufizuar të burimeve njerëzore dhe numrit tepër të lartë të stokut të çështjeve.

30. Gjykata konstaton se ky arsyetim nuk përputhet me të dhënat e tërhequra nga vetë Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, e cila ka informuar se në të ushtrojnë detyrën 13 gjyqtarë dhe se kohëzgjatja mesatare e gjykimit të çështjeve në përgjithësi dhe e çështjeve me objekt të ngjashëm të kërkuarit është 1 vit, që është tre herë më e ulët se sa kohëzgjatja e gjykimit të kërkuarit. Po kështu, ajo informon se në kohën kur çështja e kërkuarit i është caktuar gjyqtarit të tretë me short, ai kishte një ngarkesë, gjithsej, prej 332 çështjesh, ndërsa numri i çështjeve të cilat po shqyrtohen aktualisht prej tij është 568, ngarkesë e cila është dukshëm më e ulët se sa ajo e paraqitur nga gjykata e apelit në vendimin e saj – 990 çështje (*shih faqet 5 dhe 10 të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit*). Për këto arsye, Gjykata vlerëson se interpretimi i ligjit nga Gjykata Administrative e Apelit për rrëzimin e kërkesës për konstatimin e shkeljes së të drejtës së kërkuarit për gjykim brenda afatit të arsyeshëm nuk është në përputhje me Kushtetutën, ndaj vendimi i saj duhet shfuqizuar.

31. Duke i analizuar këta tregues, Gjykata çmon se vonesa në gjykimin e çështjes së kërkuarit është rrjedhojë e sjelljes së gjykatave, sipas arsyetimit të mësipërm.

32. Në lidhje me *atë çfarë rrezikon kërkuari* në procesin gjyqësor, Gjykata ka pohuar se disa kategori çështjesh, për shkak të natyrës së tyre, kërkojnë përshejtim të posaçëm të gjykimit. Disa çështje që lidhen me interesa “vetjakë e jetësorë”, nevojitet të trajtohen me përparësi dhe shpejtësi të veçantë. Lista e këtyre çështjeve nuk mund të jetë shteruese dhe



kriteri i interesit të kërkuarit në proces verifikohet nga Gjykata rast pas rasti (*shih vendimet nr. 57, datë 17.09.2024; nr. 6, datë 16.02.2023; nr. 35, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

33. Duke iu kthyer çështjes konkrete, Gjykata vëren se në themelin e saj është ndërprerja e pagës si pasojë e shkëputjes së marrëdhënieve të punës së kërkuarit. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka pohuar se mosmarrëveshjet në fushën e punësimit, për nga natyra e tyre, kërkojnë vendimmarrje të përshtetshme (*shih Vocaturo kundër Italisë, 24.05.1991, § 17*), qëndrim i cili është mbajtur edhe nga KLGJ-ja në vendimin e saj nr. 78/2019, e cila i ka vlerësuar ato si çështje prioritare për shqyrtim. Për këto arsye, si dhe duke evidentuar edhe moshën 62 vjeç të kërkuarit, Gjykata çmon se kërkuarit i rrezikohen interesa vetjakë nga vonesa e gjykimit, ndaj çështja e tij duhet të trajtohet me përparësi nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë.

34. Në përfundim, duke pasur parasysh kohëzgjatjen prej më shumë se 3 vjetësh të gjykimit të çështjes në gjykatën e shkallës së parë, natyrën jo komplekse të çështjes, sjelljen e autoriteteve, si dhe interesin vetjak të kërkuarit, Gjykata vlerëson se atij i është cenuar e drejta kushtetuese për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, ndaj kërkesa duhet të pranohet. Po kështu, bazuar në nenin 81, pika 3, të ligjit nr. 8577/2000, Gjykata çmon se duhet urdhëruar detyrimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë të shqyrtojë çështjen e kërkuarit me përparësi.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

### **V E N D O S I:**

1. Pranimin e kërkesës.
2. Shfuqizimin e vendimit nr. 50 (86-2024-1175), datë 19.06.2024 të Gjykatës Administrative të Apelit.
3. Konstatimin e cenimit të së drejtës për një gjykim brenda afatit të arsyeshëm.
4. Detyrimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë të shqyrtojë çështjen me përparësi.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

**Marrë më 21.01.2025**

**Shpallur më 19.02.2025**